



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 tetor 2021
Nr. ref.:RK 1859/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI128/21

Parashtrues

Shkelzen Mustafa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. nr. 310/2020, të 10 tetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shkelzen Mustafa, me vendbanim në Prizren (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 310/2020, i 10 tetorit 2020.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e lartcekur të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 30 dhjetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia pra Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 7 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet postës, e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 29 korrik 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj, si dhe njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 4 gusht 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.
10. Më 22 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga shkresat e rastit rezulton se qysh nga themelimi i Institucionit të Shërbimit Doganor të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi), parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune tek punëdhënësi me Kontratë pune në kohë të pacaktuar në pozitën *“Zëvendësdrejtor i departamentit të Përmbyshjes pranë Drejtorisë për zbatimin e ligjit”*.
12. Më 5 tetor 2007, Drejtori Gjeneral i Punëdhënësit, përmes Vendimit [nr. 01/262] kishte suspenduar nga puna parashtruesin e kërkesës.
13. Më 26 maj 2008, Komisioni Disiplinor i Punëdhënësit, përmes Vendimit [nr. 07/175] i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës duke konsideruar se ky i fundit kishte bërë shkelje të rënda të detyrave të punës të parapara me Kodin e Mirësjelljes të Punëdhënësit, përkatësisht *“pika 3.1, nën pika 1.4.8, pika 4.2 dhe pika 15.4 nën pika 1 të përcaktuar me UA mbi procedurat sipas aneksit 1 Kategoria 2 pika 1 dhe 15 si dhe shkelje të kodit Doganor (Rregullorja e UNMIK-ut) seksioni 86, pika b. dhe konform nenit 12.4, pika 9 të Udhëzimit Administrativ mbi procedurën disiplinore”*.
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në shkallën e dytë pranë punëdhënësit, kundër Vendimit të lartpërmendur të Komisionit Disiplinor të Punëdhënësit.
15. Më 12 qershor 2008, instanca e dytë e punëdhënësit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin [nr. 07/175] të 26 majit 2008 të Komisionit Disiplinor të Punëdhënësit.
16. Më 7 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 216/15] kishte liruar parashtruesin e kërkesës nga akuza për kryerjen e veprës penale nga neni 339, par. 1 *“shpërdorim i pozitës zyrtare”* të Kodit Penal të Kosovës.
17. Më 30 qershor 2008, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me propozimin që të anulohet Vendimi [nr. 07/175] i Komisionit Disiplinor të Punëdhënësit, duke kërkuar si në vijim: i) që të kthehet në vendin e punës; ii) të kompensojë si dëmshpërblim të gjitha të ardhurat e parealizuara në vlerë prej 101.000 euro për periudhën kohore nga 4 tetori 2007 deri në kthimin e tij në vendin e punës; dhe iii) t’ia kompensojë të gjitha shpenzimet procedurale.
18. Më 23 janar 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [C. nr. 258/2008], vendosi si në vijim: i) refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe ii) i obligoi që secila palë t’i bartë për vete shpenzimet procedurale. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë theksohet se Vendimi i Komisionit Disiplinor i Punëdhënësit ishte i drejtë dhe

se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar që të paraqesë mjetet juridike, si dhe ankesën në shkallë të dytë brenda institucionit.

19. Për më tepër, në Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore shtohet se:

“Gjykata vlerësoi se masa disiplinore paditësit i është shqiptuar në pajtim me natyrën e shkeljes së detyrave të punës, që në rastin konkret ka të bëjë me keqpërdorim të punës dhe detyrave të tij, në pajtim me efektet që synohen të arrihen dhe në procedurë të rregullt disiplinore dhe se me asnjë provë paditëse nuk arriti që gjykatës t’ia vërtetoj faktin se nuk ka bërë shkelje disiplinore”.

20. Më 20 mars 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të [C. nr. 258/2008] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
21. Më 16 dhjetor 2019, Gjykata Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 2308/17], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata e Apelit në arsyetim të vendimit të saj shtoi se Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Themelore në Prishtinë ishte i drejtë dhe i ligjshëm, ku ndër të tjera shtoi se *“Në rastin konkret nuk është shumë relevante epilogu i procedurës penale, në rast se procedura disiplinore nuk është e varur nga ajo penale, gjë që në rastin konkret sipas vlerësimeve të Gjykatës së Apelit, procedura disiplinore është e veçantë, ka prova të mjaftueshme me të cilat me të drejtë është vërtetuar në procedurë disiplinore por edhe nga ana e Gjykatës së shkallës së I-rë, përgjegjësia disiplinore e paditësit”.*
22. Më 26 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 10 tetor 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 310/2020] refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Supreme në arsyetim të Aktgjykimit të saj konstatoi se Gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia pra Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon se si gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore kundër tij pranë punëdhënësit ashtu edhe gjatë zhvillimit të

procedurave pranë gjykatave të rregullta, janë përdorur prova të papranueshme kundër tij, ku më tutje parashtruesi shton se në bazë të po këtyre provave Gjykata Themelore në Prishtinë kishte liruar nga akuza parashtruesin e kërkesës.

26. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se *“nëse kjo vlenë për mua dhe ekskluzivisht për mua atëherë si është e mundur që tre të bashkakuzuarit të kthehen në punë dhe të mos bartin asnjë pasojë”*.
27. Parashtruesi më tutje shton se në rastin e tij, procedura penale ka zgjatur për më shumë se 10 (dhjetë) vite, duke theksuar se *“gjykimi i tejzgjatur nuk është drejtësi”*.
28. Parashtruesi i kërkesës në vijim shton se *“Më është cenuar e drejta e privatësisë me marrjen e mesazheve pa një urdhër të gjykatësit të procedurës paraprake që ka të bëjë me shkelje të nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - e drejta e privatësisë”*.
29. Krejt në fund, parashtruesi i kërkesës shton se *“Gjykatat e lartcekura fare nuk janë bazuar në praktikën gjyqësore edhe përkundër faktit se paditësi për rastin e njëjtë ka prezantuar kopjet e aktgjykimeve ku janë aprovuar kërkesat e paditësve, ndërsa në rastin tim më është refuzuar kjo kërkesë”*.
30. Parashtruesi i kërkesës në mbështetje të këtij pretendimi dorëzoi në Gjykatë dy aktgjykime të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke pretenduar se në disa raste të tjera të ngjashme Gjykata Themelore në Prishtinë kishte vendosur ndryshe.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulon vendimin e kontestuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

35. Gjykata më tej i referohet edhe rregullit 30 [Llogaritja e periudhës kohore] dhe 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës:

Rregulli 30
[Llogaritja e periudhës kohore]

Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore të punës, llogaritet si më poshtë:

[...]

(3) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore.

(6) Ndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(c) *kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit.*

36. Gjykata fillimisht i referohet datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar të kontestuar nga parashtruesi, si dhe datës së parashtrimit të kërkesës në Gjykatë, për të vlerësuar nëse parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të caktuar ligjor prej 4 (katër) muajve.
37. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje që vendimi i fundit në rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, [Rev. nr. 310/2020] i 10 tetorit 2020.
38. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, nuk kishte deklaruar se kur e kishte pranuar vendimin e kontestuar. Pas kërkesës së Gjykatës, Gjykata Themelore në Prishtinë, në përgjigjen e saj të 4 gushtit 2021, dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën ku vërehet se parashtruesi vendimin e kontestuar e ka pranuar më 30 dhjetor 2020.
39. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 30 dhjetor 2020, ndërsa kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar më 7 korrik 2021, që do të thotë se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.
40. Duke u referuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Gjykata vë në dukje se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe për të parandaluar autoritetet dhe palët e tjera të interesuara që të mbahen në gjendje të pasigurisë për një periudhë më të gjatë kohore (shih rastet e Gjykatës: KI140/13, parashtrues i kërkesës, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24; KI49/18, parashtrues i kërkesës *Ilmi Sopa*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 55; KI109/19, parashtrues i kërkesës *Mehmet Qerimi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 shkurtit 2020, paragrafi 37; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: *Olivier Gaillard kundër Francës*, nr. 47337/99, të 11 korrikut 2000; *Franz Hofstädter kundër Austrisë*, nr. 25407/94, 12 shtator 2000).
41. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqes kërkesë dhe të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur (shih rastet e Gjykatës, KI49/18, parashtrues i kërkesës *Ilmi Sopa*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 56; rastin KI109/19, parashtrues i kërkesës *Mehmet Qerimi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 shkurtit 2020, paragrafi 38). Kjo në të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve të rastit, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik (shih Vendimi i GJEDNJ-së, *Nee kundër Irlandës*, nr. 52787/99, i 30 janarit 2003).

42. Në vijë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata thekson se kufizimi kohor i afatit për kontrollin kushtetues të ushtruar nga Gjykata paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për hapësirën kohore pas të cilit kontrolli i tillë nuk është më i mundur (shih, *mutatus mutandis*, vendimet e GJEDNJ-së: *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, i 25 janarit 2000; *Sabri Güneş kundër Turqisë*, i 29 qershorit 2012, paragrafi 40).
43. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse kërkesa e parashtruesit është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 22 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Qesra Caka-Nimani